



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti - Republika Kosova – Republic of Kosovo

**MAMUŞA BELEDİYE - KOMUNA E MAMUSHËS
OPSTINA MAMUSA - MUNICIPALTY OF MAMUSA**

RREGULLORJA

**PËR ORARIN E PUNËS TË SUBJEKTEVE AFARISTE NË
TERRITORIN E KOMUNËS SË MAMUSHËS**

Në bazë dispozitive të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Ligjit Nr. 03/L-038 mbi Vetëqeverisjen Lokale si dhe të dispozitive të Statutit të Komunës së Mamushës, Kuvendi Komunal i Komunës së Mamushës në mbledhjen e mbajtur më 28.02.2012 miratoi këtë:

R R E G U L L O R E

PËR ORARIN E PUNËS TË SUBJEKTEVE AFARISTE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË MAMUSHËS

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet fillimi dhe mbarimi i orarit të punës të subjekteve afariste në Komunën e Mamushës, në lëmin e ekonomisë, tregtisë, hotelerisë, zejtarisë dhe shërbimeve të tjera.

Neni 2

Subjektet që zhvillojnë veprimtari afariste në Komunën e Mamushës gjatë ditëve të punës prej të Hënës deri të Premten, do të kenë këtë orar të punës:

- | | |
|---|-------------------------------------|
| 1. Restorantet, kafenetë dhe kafiteritë..... | 06 ^{oo} -23 ^{oo} |
| 2. Kuzhinat popullore,qebaptoret,ëmbëltoret e çajtoret | 07 ^{oo} -23 ^{oo} |
| 3. Shitoret me gjëra ushqimore..... | 08 ^{oo} -23 ^{oo} |
| 4. Zejtarët, tregtia me gjëra joushqimore..... | 08 ^{oo} -21 ^{oo} |
| 5. Furrat e bukës non stop (jo obligative), por mund të punojnë | 05 ^{oo} - 22 ^{oo} |
| 6. Ambulancat dhe barnatoret e sektorit privat..... | 07 ^{oo} -21 ^{oo} |
| 7. Veprimtaritë rekreative,sportive dhe kulturore | 08 ^{oo} -22 ^{oo} |
| 8. Veprimtaritë prodhuese (nëse nuk i pengojnë qytetarët).... | non-stop |
| 9. Pompat e benzinës..... | non-stop |

- 10.Hotelet dhe motelet..... non-stop
11.Disko klubet (të premten dhe të shtunën) punojnë prej orës 20^{oo}-6^{oo}
kurse ditëve tjera prej orë 19^{oo}- 23^{oo}.
12.Internet kafetë do të punojnë non-stop 24 orë.

Përveç veprimtarive hoteliere, barnatoreve, salloneve të frizerëve dhe kiosqeve që shesin vetëm shtypin ditor, e Diela është ditë pushimi.

Orarin e kujdestarisë për shitoret e gjërave ushqimore, që do të punojnë të dielave dhe gjatë festave, do ta bëjë Drejtoria për Buxhet dhe Financa, në bazë të datave të licencimit komunal të Biznesit. Kujdestarinë do ta mbajnë një shitore në Mamushë.

Përfundimisht, në raste të veçanta (dasma, ahengje, matura, ditëlindje, dasma-syneti, përvjetorë etj) mund të lejohet zgjatja e orarit të punës me leje të posaçme, lëshuar nga DBF.

Neni 3

Orari i punës, i caktuar me këtë Rregullore, duhet të vendoset në hyrje të lokalit, në vend të dukshëm, ku zhvillohet veprimtaria afariste .

Neni 4

Veprimtaritë të cilat prishin qetësinë e qytetarëve (prodhimi i zhurmës,muzika e zëshme) nuk lejohen gjatë orarit të punës nëse janë më afër se 100m nga ndërtesa e banimit. Lartësia e zhurmës nuk lejohet të kaloj në burim të shkaktarit të zhurmës 35 decibel gjatë ditës, kurse gjer në 30 decibel gjatë natës. Kjo vlen për zonat e banuara. Lartësia e zhurmës matet me fonometër.

Neni 5

Ambulancat dhe barnatoret private mund të mbajnë kujdestari, përveç ditëve të punës, të dielave dhe ditëve të festave.

Neni 6

Kërkesa për zgjatjen e orarit të punës i drejtohet Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, së paku tri ditë pune më parë ndërsa pas marrjes së pëlqimit për zgjatjen e orarit të punës pala është e obliguar të njoftojë policinë.

Për marrjen e pëlqimit për zgjatjen e orari të punës, pala është e obliguar të bëjë pagesën, në shumë prej 10€

Për zgjatjen e orarit respektivisht lejimi i punes per diten “e Diel”, pagesa do te jete 10 euro për një dite kurse për gjithë muajin 30 euro.

Dispozitat ndëshkuese

Neni 7

Të gjitha subjektet, të cilat nuk respektojnë orarin e punës, të fillimit dhe të mbarimit, paraqitur në këtë rregullore, pas konstatimit nga ana e inspekcioni, do të dënohen në shumë prej 100 € Dënimi është mandator dhe shqiptohet nga inspektori kompetent.

Ndaj të gjitha subjekteve afariste që kundërshtojnë nenet e parapara të kësaj Rregulloreje, do të ushtrohet fletëparaqitje në Gjykatën për Kundërvajtje, ku parashihet gjoba në vlerë prej 300-1.500€

Neni 8

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria e Shërbimeve Publike respektivisht Inspektorati Komunal, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës.

Neni 9

Kjo Rregullore shfuqizon të gjitha vendimet e mëparshme të Kuvendit Komunal të Komunës së Mamushës, që kanë rregulluar fillimin dhe mbarimin e orarit të punës për subjektet afariste.

KUVENDI I KOMUNËS SË MAMUSHËS

01 Nr. /01-12

Më 28.02.2012

Mamushë

**Kryesuesja e Kuvendit Komunal
Seylan Mazrek**